Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)

Si pjesë integrale e ISHTI, është edhe Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN) që vepron në përputhje e në zbatim të dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi: ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqiperisë"; ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; si dhe të gjitha akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre.

Bazuar në ligjin e posaçëm nr.8450, datë 24.02.1999, të ndryshuar , DING ushtron kontrolle në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, **<u>për zbatimin e kushteve të parashikuara në licencat, lejet apo autorizimet përkatëse që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat mbrojtëse kundra zjarrit.</u>**

Drejtimet kryesore të këtij kontrolli janë :

- Respektimi i normave teknike dhe i masave të mbrojtjes nga zjarri në instalimet, impiantet dhe pajisje që përdoren nga persona juridike;

- respektimi i treguesve cilësore i standardeve ligjore dhe dispozitave të tjera ligjore e nënligjore, në parandalimin e abuzimeve dhe falsifikimeve që mund të kryhen nga persona juridike;

- respektimi i dispozitave ligjore e nënligjore, lidhur me rezultatet financiare dhe plotësimit të detyrimeve fiskale të personave juridike ndaj shtetit.

Cilesia naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në vendin tonë tashme mbikqyret që të jetë në përputhje me standardet e bashkimit europian, kjo si rrjedhoj edhe e ndryshimeve të pasqyruara në legjislacion..Respektimi i standardeve për cilësinë e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre mbështetet nga kuadri ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqiperisë" dhe në ligjin e posaçëm nr.8450, datë 24.02.1999, të ndryshuar "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", si dhe në zbatim të akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre.Dispozitave të këtij kuadri ligjor u nënshtrohen, pa asnjë dallim, të gjithë personat juridike, publike ose private, vendas apo të huaj, që kanë si objekt të veprimtarisë se tyre përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Jetëgjatësia e mjeteve që qarkullojnë në Shqipëri është një nga problemet që lidhet edhe me cilësinë lëndës djegëse me të cilën ato punojnë pra një punë normale të motorëve dhe eliminimin e ndotjes së mjedisit.

Kontrolli i cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj bëhet në zbatim të VKM nr.147, datë 21.03.2007, "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel", të VKM nr. 429, datë 26.6.2019, "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e

industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)" dhe të standardeve të sejcilit produkt si dhe metodikave të testimit për çdo tregues që jepet nga standardet përkatëse në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit(DPS).
Për kontrollet cilësore zbatohen kërkesat dhe procedurat që jepen në urdhërin nr.6, datë 09.01.2015 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të ndryshuar, "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, proçedurat dhe tarifat përkatëse".
Sistemi i kontrollit për cilësinë e karburanteve është plotësisht shtetëror (nuk ka laborator jo public të akredituar kombtarisht apo ndërkombëtarisht).
Mostërmarrja për çdo produkt dhe për çdo rast kryhet nga inspektor ose grupe inspektoresh të ISHTI-së dhe sillet në dhomën e kodifikimit pranë zyrave tona dhe prej andej ena me mostrën që do të analizohet kalon në Laboratorin Qendror të Kontrollit që është pjesë integrale e ISHTI-së.

Në zbatim të metodave të testimit, për çdo tregues, kryen analiza laboratorike dhe vlerat e rezultuara hidhen në raport analizimin e produktit që është mostruar. Kontrolli cilësor ka qëllim kapjen e antiinformalit, fallcifikimeve, abuzimeve dhe gabimet subjektive që mund të ndodhin gjatë punës me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, veprime që mund të shkaktojnë dëme: - në jetën e personelit shfrytëzues, etj, - ekonomik, - ndotje mjedisore dhe dme në investime kapitale, Antiinformalit, fallcifikimet, abuzimet dhe gabimet subjective që mund të ndodhin gjatë prodhimit vendas, importimit, depozitimit, përpunimit, transportimit dhe deri te shitja me shumicë dhe pakicë janë arsye për rritje dhe përsosje në mënyrën e kryerjes së kontrollit cilësor Mbështetur në eksperiencën e mëparshme në këtë drejtim, situatave konkrete në fushën hidrokarbure, mendojmë se ruajtja befasinë për momentin e marrjes së mostrave për rastin e kontrollit cilësor periodik / sontazh është element kyç në këtë process ashtu si dhe saktësia e kryerjes së sejcilit process.

Institucioni janë afron sherbim çdo subjekti,

- që kërkon kontroll të satndardit teknik të naftës dhe nënprodukteve të saj në zbatim të urdhrit nr.6, datë 09.01.2015 të Ministrise së Infrastrukturës dhe Energjise, "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse", të ndryshuar me urdhrin nr. 32, datë 02.02.2016, për rastet:

- për sasitë e prodhuara në vend, para hedhjes në treg,
- për sasitë e importuara para zhdoganimit, duke përfshirë edhe subjektet që oprojnë magazinat e lira doganore,
- kërkohet nga vetë subjekti kryerja e analizave laboratorike (për të tretë) .

ISHTI fillon procedurën e mostërmarrjes pasi të paktën dy ditë më parë të jete njoftuar me shkrim nga subjekti përkatës (kërkesa e shoqëruar me dokumentacionin e duhur sipas rastit). Marrja e mostrës kryhet në zbatim të procedurave të dhëna në kreun II të urdhrit nr.6 të MEI, datë 09.01.2015, por për të tretë mostra/t mund të sillet nga ana e subjektit ku duhen 2 litra produkt hedhur në dy enë të pastërta (një përdorimshe) me vëllim 1 litër sejcila. Në momentin e marrjes së mostrës ose dorëzimit të saj nga subjekti në protokollin e ISHTI-së

(rasti për të tretë) pritet fatura për pagesën e tarifës sipas specifikimeve të dhëna në aneksin nr.1 të urdhrit nr. 6.

Përgjigjet për analizimet e kryera merren pas pesë ditëve pune pranë ISHTI-së, duke sjell njëkohësisht dokumentin bankar mbi pagesën e faturës së prerë.

Procedura e ankimimit kryhet në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqiperisë” dhe në ligjin e posaçëm nr.8450, datë 24.02.1999, të ndryshuar